Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo

Autoriteti Kombëtar i Kualifikimeve
Nacionalni Autoritet za Kvalifikacije
National Qualification Authority

Numër: 01/229
Datë: 29.04.2022

Në mbështetje të neneve 6 dhe 16 të Ligjit Nr.03/L-060 për Kualifikimet Kombëtare, si dhe Udhëzimit Administrativ të Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë (MASHT) për Kriteret dhe procedurat për akreditimin e institucioneve që zbatojnë njohjen e mësimit paraprak në Kosovë nr. 09/2019, Këshilli Drejtues (KD) i Autoritetit Kombëtar të Kualifikimeve (AKK), në mbledhjen e mbajtur me datë 29.04.2022 nxjerrë këtë:

V E N D I M

1. **Akreditohet** institucioni "Britannica ELT School", me qendrën kryesore 1. në adresën: Kroi i Bardhë, p.n. 10000 Prishtinë, dhe degën, 2. me adresë Rruga Lidhja e Prizrenit, p.n. 10000, Prishtinë, Republika e Kosovë, për periudhën tre (3) vjeçare, përkatësisht nga data 29.04.2022 deri me 28.04.2025, për të ofruar, vlerësuar dhe certifikuar këtë kualifikim:

    1.1 **Kurse të Gjuhës Angleze, niveli A1 deri në C2.** Institucioni mund të realizojë procesin e aftësimit për qendrën kryesore deri në dhjetë (10) kandidatë brenda një grupi dhe gjatë një viti mund të mbahen deri në 12 grupe, ndërsa për degën deri në pesëmbëdhjetë (15) kandidatë brenda një grupi dhe gjatë një viti mund të mbahen deri në 12 grupe.

2. Ky vendim hyn në fuqi me nënshkrimin e tij.

A r s y e t i m

Në bazë të kërkesës së "Britannica ELT School", për akreditim dhe rekomandimeve të dala nga Raporti i ekipit të ekspertëve mbi akreditimin e institucionit, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Rekomandimet përfundimtare të ekipit të ekspertëve janë të mbështetura në dëshmi dhe dokumente të ofruara nga institucioni në fazën e aplikimit: Aplikacionin për akreditim si

institucion ofrues dhe/ose vlerësues dhe lëshues të kualifikimit; Raportin e Vetëvlerësimit; Vizitën në institucionin/ofruesin aplikues, si dhe dokumente tjera shtesë.

Pas trajtimit në detaje nga ekipi i ekspertëve të dokumentacionit të sipërpërmendur dhe të gjeturave nga vizita, ekipi i ekspertëve në raportin e hartuar dha vlerësim pozitiv, dhe të njëjtin ia rekomandoi Këshillit Drejtues për vendimmarrje. Mbi këtë bazë, Këshilli Drejtues, bazuar në kompetencat e tij, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike: Kundër këtij vendimi mund të paraqitet ankesa për rishqyrtim të vendimit sipas nenit 20, pikat 1, 2, 3 dhe 4 të Udhëzimit Administrativ të MASHT për Kriteret dhe procedurat për validimin dhe aprovimin e kualifikimeve kombëtare dhe akreditimin e institucioneve që ofrojnë kualifikime në Kosovë me Nr. 35/2014. Ankesa kundër këtij akti administrativ i dorëzohet KD të AKK, në afat prej 15 ditësh pas lëshimit të vendimit.

Vendimi u dërgohet:

1. Institucionit, Britannica ELT School, dhe
2. Arkivit të AKK-së.

Prof. Dr. Agron BAJRAKTARI

Kryetar KD së AKK